

Bahri Beci

VALLE

SHKRONJASH DHE TINGUJSH



LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË

Bahri Beci

VALLE

SHKRONJASH DHE TINGUJSH

GJUHA SHQIPE 2
për klasën II të shkollës fillore nëntëvjeçare

LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2006

Dr. Bahri Beci

**VALLE SHKRONJASH DHE TINGUJSH
GJUHA SHQIPE 2**

**për klasën e dytë të shkollës fillore nëntëvjeçare
LIBRI I MËSUESIT**

**ИГРА СЛОВА И ГЛАСОВА
АЛБАНСКИ ЈЕЗИК 2**

**за други разред основне деветогодишње школе
ПРИРУЧНИК**

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

**Kryeredaktore dhe
redaktore përgjegjëse:** Natasha Zhivković

Redaktor: Zarija Brajović

Recensentë: Prof. dr. Mark Camaj
Prof. dr. Pjetër Gjuravçaj
Nazire Kurmemović, mësuese e ciklit të ulët
Prof. dr. Fatmir Vadahi, pedagog
Prof. dr. Vehbi Hoti, psikolog

Ilustrimi dhe faqosja: Milena Perović
Dushan Lakiqević

Disenjoja dhe faqosja: Milena Perović

Korrektor: Dimitrov Popović

Redaktor teknik: Rajko Radulović

Për botuesin: Nebojša Dragović

Shtypur në Studio "MOUSE"; Podgorica

Tirazhi: 50

ISBN: 978-86-303-1044-7

Këshilli i Arsimit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 04-3-45 të datës 16.04.2007 e ka miratuar këtë tekst mësimor për përdorim në shkollat fillore nëntëvjeçare.

PASQYRA E LËNDËS

I. Rreth përmbajtjes së Programit të Gjuhës amtare për klasën e dytë.....	4
II. Metodatat e mësimdhënies	6
- Metoda sintetike	
- Metoda analitike	
- Metoda globale	
- Metoda analitiko-sintetike	
III. Llojet e të lexuarit në mësimin fillestar të shkrim-leximit.....	8
IV. Përmbajtja e Tekstit mësimor dhe e Fletores së punës	8
V. Struktura e Tekstit mësimor dhe e Fletores së punës	9
Kapitulli i parë: <i>Shohim dhe tregojmë</i>	
Kapitulli i dytë: <i>Lexojmë dhe shkruajmë</i>	
- Shkronjat e shtypit	
- Shkronjat e dorës	
- Njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore	
Kapitulli i tretë: <i>Flasim bukur</i>	
Kapitulli i katërt: <i>Ne dhe bota përreth</i>	
VI. Ecuria metodike për realizimin e synimeve	17
Modele mësimesh:	
- <i>Kur nuk kishte telefon.</i>	
- <i>Ndalimet, paralajmërimet dhe lajmërimet (1).</i>	
- <i>Ndalimet, paralajmërimet dhe lajmërimet (2).</i>	
- <i>Toka është e rrumbullakët.</i>	
- <i>Çfarë janë retë?</i>	
- <i>Çfarë është lopa?</i>	
- <i>Çfarë është Dielli?</i>	
- <i>Çfarë është deti?</i>	
- <i>Çfarë janë pemët?</i>	
- <i>Njerëzit, kafshët dhe bimët ushqehen</i>	
- <i>Trupi ynë</i>	

RRETH PËRMBAJTJES SË PROGRAMIT TË GJUHËS AMTARE PËR KLASËN E DYTË

Synimet kryesore të mësimit të gjuhës amtare në shkollë janë zhvillimi i aftësive dhe shprehive **për të dëgjuar, për të folur, për të lexuar** dhe **për të shkruar**. Këto janë në të njëjtën kohë edhe elementet kryesore përbërëse të mësimit të gjuhës amtare në klasën e dytë të shkollës fillore.

Në ciklin e parë të shkollës fillore, **të dëgjuarit** është një nga burimet më të rëndësishme për të fituar njohuritë, sepse ata nuk dinë të lexojnë ende. Fëmijët e mësojnë gjuhën amtare me anën e të dëgjuarit. Fjalori pasiv i nxënësve të kësaj moshe është shumë më i madh sesa fjalori aktiv, prandaj ata kuptojnë shumë më tepër sesa janë të aftë të shprehen gojarisht.

Të dëgjuarit ka rol vendimtar në mësimin e shkrimit dhe të leximit. Përmes të dëgjuarit, ata do të mund të kuptojnë se fjalët përbëhen nga tinguj, çka është me rëndësi dhe do t'u shërbejë në procesin e të mësuarit të leximit dhe të shkrimit.

Të folurit njerëzit e përdorin për të ndikuar mbi qeniet e tjera. Edhe pse tek njeriu ekziston baza biologjike për zhvillimin e të folurit, ai mbetet një nga veprimtaritë më të vështira, për të cilën nevojitet shumë punë për t'u zhvilluar.

Zhvillimi i të folurit do të jetë më i shpejtë, nëse tregojmë kujdes për zhvillimin e tij tek fëmijët. Për këtë arsye fëmijëve duhet t'u këndohet, t'u flitet dhe t'u lexohet sa më shumë. Gjithashtu, duhet t'u ofrohet mundësia, që edhe ata vetë të flasin sa më shumë.

Zhvillimi gjuhësor pasqyrohet përmes rritjes cilësore dhe sasiore të aftësisë së fëmijëve për të perceptuar e përdoruar tingujt, për

të zgjeruar fjalorin, për të njohur e përdoruar struktura të ndryshme të fjalive, për të dalluar kuptimet e fjalëve, të fjalive dhe përmes rritjes së aftësisë së tyre për të marrë pjesë gjallërisht në situata të ndryshme komunikative.

Zhvillimi i të folurit përfshin përvetësimin e rregullave fonologjike, semantike dhe morfosintaksore.

Studimet tregojnë se fjalori aktiv i fëmijëve të moshës 6-7 vjeçe nuk është shumë i pasur. Studiuesit japin shifrat nga 2500-2600 fjalë, të cilat fëmijët i përdorin aktivisht, ndërsa fjalori i tyre pasiv është shumë më i pasur.

Është e sigurt, se ekziston një lidhje reciproke midis zhvillimit të të folurit të fëmijës dhe shkrim-leximit fillestar. Niveli i zhvillimit të të folurit të fëmijës, si kusht për përvetësimin e të lexuarit dhe të të shkruarit, është ndoshta më i rëndësishëm sesa aftësia njohëse e tij.

Të lexuarit nuk është pasojë e zhvillimit biologjik të njeriut, por e atij kulturor dhe aftësia për të lexuar nuk ekziston si e lindur. Procesin e fitimit të kësaj shkathtësie, sigurisht, e vështirëson fakti, se lidhja midis tingullit dhe shenjës së tingullit nuk është natyrore, por e bërë me marrëveshje.

Të lexuarit, madje edhe në heshtje, realizohet duke përdorur të parit, por edhe të dëgjuarit. Fazë kritike në procesin e të lexuarit është shndërrimi i shkronjave në tinguj. Tek mësimi i të lexuarit më i rëndësishëm është përvetësimi i lidhjeve midis shkronjave dhe tingujve, si edhe i rregullave të zëvendësimit të tyre (parimi alfabetik). Që lexuesi të mund ta zbatojë parimin alfabetik, ai duhet të vërë re, se prej çfarë tingujsh (fonemash) është e përbërë

fjala. Kjo do të thotë, se ai mund ta ndajë fjalën në tinguj, d.m.th. "të dëgjojë" me mend tingujt sipas rendit me të cilin janë radhitur në fjalë.

Edhe pse për përgatitjen e nxënësve për procesin e mësimin sistematik të shkrim-leximit është punuar gati një vit shkollor, dallime midis nxënësve ka, kur është fjala për përgatitjen për zotërimin e kësaj shkathtësie. Këto dallime duhen marrë në konsideratë, kur përgatitni planin e realizimit të mësimin fillestar të leximit, në mënyrë që të mund t'u përgjigjeni nevojave të ndryshme të nxënësve të klasës suaj. Për këtë qëllim, duhet kontrolluar niveli i njohurive ekzistuese të nxënësve, kur është fjala për shkathtësitë e paraleximit e të leximit dhe të ndiqet përparimi i tyre. Në bazë të këtyre të dhënave, fëmijëve që përparojnë më shpejt u jepen tekste të shkruara më të ndërlikuara dhe detyra më të vështira. Për lexuesit e ngadalshëm, duhet të përgatitni materiale interesante, që do t'u mundësojnë atyre për të fituar shkathtësitë që u mungojnë. Meqë shkathtësitë e leximit e të shkrimit zhvillohen paralelisht, duhen organizuar veprimtari në të cilat ato ndërthuren.

Të shkruarit është proces i anasjelltë në raport me leximin. Kur mëson shkronjat dhe fiton ndjeshmërinë të dallojë tingujt, fëmija, jo vetëm që mund ta lexojë, por mundet edhe ta shkruajë një fjalë të caktuar. Në kuadër të këtij procesi, ai përcakton tingujt e fjalës, kujton shenjat grafike për to dhe i shkruan sipas renditjes së drejtë nga e majta në të djathtë.

Të mësuarit e leximit e të shkrimit është një veprimtari e ndërlikuar, e cila bazohet në zhvillimin e të folurit. Të folurit dhe të shkruarit ndërthuren ndër vete. Me zhvillimin e komunikimit me të dëgjuar dhe me të folur, përmirësohet edhe të shkruarit.

Në shkrim ndikojnë ushtrimet e parashkrimit, të cilat përfshijnë veprimtaritë e ndryshme: mbajtjen si duhet të trupit gjatë të shkruarit, mbajtjen dhe përdorimin e mjeteve të ndryshme

të shkrimit; orientimin në hapësirë dhe në letër, drejtimi i të shkruarit nga e majta në të djathtë, nga lart poshtë, lëvizjet me të cilat formohen shkronjat përmes ushtrimeve të ndryshme në hapësirë dhe në letër.

Jepuni nxënësve tuaj raste të shumta të ndryshme, që të shkruajnë, sepse, sa më shumë që të shkruajnë, aq më të theksuar e kanë nevojën për këtë veprimtari. Dallojmë të shkruarit si veprimtari motorike dhe të shkruarit si veprimtari krijuese.

Të shkruarit si veprimtari motorike përfshin proceset e mëposhtë: ruajtjen në vetëdije të figurës së shkronjës si shenja e një tingulli të caktuar dhe mbajtjen mend, përkatësisht rikthimin e kësaj figure, kur është e nevojshme. Edhe pse duket e thjeshtë, kjo veprimtari përbëhet nga shumë "nënshkathtësi", kështu që, mësuesit janë dëshmitarë se tek një numër i caktuar fëmijësh, të cilët e zotërojnë këtë shkathtësi, mund të dalin vështirësi motorike.

Çdo njeri, me kalimin e kohës, formon shkrimin e vet, i cili është shprehje e individualitetit të tij. Mësimi bashkëkohor i të shkruarit duhet të synojë një shkrim të qartë e të lexueshëm. Dikur, në fletoret e bukurshkrimit, kanë qënë të shtypura modelet e vijave, të cilat duhej t'i shkruanin të gjithë nxënësit. Mendohej, se të gjithë nxënësit duhej ta kishin dorëshkrimin e njëjtë, i cili mësohej njëllë në të gjitha shkollat. Ndërkohë, kur nxënësit rriten, secili ka shkrimin e vet (shkrim individual). Gjatë shkrimit, individi bën një aktivitet krejt të pavarur. Përdorimi i metodave bashkëkohore në mësimin e shkrimit duhet të sigurojë arritjen e një shkrimi të qartë e të lexueshëm, i cili do të mundësojë shprehjen personale. Prandaj, gjatë mësimin të shkrim-leximit, fëmijëve duhet t'u mësohen format sa më të thjeshta, pa lëvizje të tepruara (lakime e përdredhime).

Të shkruarit si veprimtari motorike dhe të shkruarit si veprimtari krijuese, janë dy procese

që ndërthuren dhe kushtëzohen ndër vete. Nxënës-i/ja që ka vështirësi motorike, do ta hartojë më ngadalë një tekst, të cilin, me gojë ndoshta do të mund ta formulonte më lehtë. Kurse nxënës-it/et pa vështirësi të tilla, jo vetëm

që e kanë shkrimin më të mirë, por e kanë më të mirë edhe sasinë dhe cilësinë e tekstit të shkruar. Është e qartë, se mënjanimi i vështirësive motorike të të shkruarit, do t'i përmirësonte edhe shkathtësitë në hartimin e tekstit.

METODAT E MËSIMDHËNIES

Metodat e mësimdhënies mund të grupohen në tri grupe themelore: në metodat sintetike, analitike dhe globale.

Kriter për këtë ndarje është, nëse fillon mësimi i të lexuarit dhe i të shkruarit nga elementet e gjuhës (tingujt dhe shkronjat) për të vazhduar më tej me tërësitë më të mëdha (fjalët, fjalitë, tekstet), apo fillon nga tërësitë për të vazhduar më tej me elementet e tyre përbërës.

Metoda sintetike

Metoda sintetike parapëlqen ta fillojë mësimin e leximit nga studimi i shenjave tingullore ose shkrimore duke shkruar nga më e thjeshta tek më e komplikuar (tingulli, shkronja, rrokja, fjala...).

Përparësia e metodës sintetike është, se ajo ngulmon në kuptimin e elementeve përbërëse të të folurit dhe të të shkruarit (tingulli, shkronja, rrokja, fjala).

Metoda analitike

Metoda analitike nisat nga e tëra (teksti, fjalia, fjala) për të arritur tek e veçanta (tek tingulli, përkatësisht tek shkronja).

Përparësia e metodës analitike qëndron në atë, se ajo e zhvillon të menduarit dhe nxit të kuptuarit e asaj që lexohet.

Metoda globale

Metoda globale fillon në shekullin XVIII nga Nicolas Adam. Ajo është e kundërta e metodës sintetike: ajo parapëlqen ta fillojë mësimin e leximit duke u nisur nga kuptimi.

Metoda globale nisat nga predispozita, se fëmija i sotëm jeton në një mjedis, ku vazhdimisht është në kontakt me një mori materialesh të shkruara; nga emërtimi i rrugëve, shesheve, dyqaneve, reklamave, llojeve të ndryshme të lajmërimeve dhe deri tek televizioni dhe tekstet e ndryshme (informacionet e shkruara: etiketat e prodhimeve, librat, gazetatat, revistat). Me kon-

ceptin metodë globale, nënkuptohet mënyra me të cilën sendi ose figura e tij, respektivisht ngjarja ose pamja e saj, bashkohen në vetëdije bashkë me fjalën ose fjalinë. Në këtë rast, fjala nuk ndahet në elementet e saj, por me anë të përsëritjes ngulitet në vetëdije si një e tërë me një kuptim të caktuar. Të lexuarit fillon me mbajtjen mend të fjalëve e të fjalive. Njësia bazë e të lexuarit, sipas kësaj metode, është fjala, imazhi grafik i së cilës transmetohet si figurë. Në kuadër të kësaj metode, mund të nisemi nga fjalia ose nga një tekst i shkruar i gjatë.

U propozohen fëmijëve fjali me fjalë të njohura prej fëmijëve. Ata duhet t'i njohin ato në mënyrë globale. Pas disa muaj ushtrimesh të këtij lloji, fëmija gradualisht dhe pak nga pak fillon të ndërtojë kodin shkrimor, gjithmonë pa u ndalur as dhe në një moment në analiza sintetike.

Kjo metodë i përshtatet më shumë mësimit të të lexuarit dhe të të shkruarit në gjuhët që kanë një drejtshkrim etimologjik si anglishtja dhe frëngjishtja. Në të vërtetë studiuesit e sotëm janë kundër përdorimit të saj, madje dobësitë e vëna re në mësimin e leximit dhe të shkrimit i shpjegojnë me përdorimin e kësaj metode.

Metoda analitiko-sintetike

Metoda analitiko-sintetike ka si pikënisje tekstin, fjalitë dhe fjalët, d.m.th. analizën e tyre. Në mënyrë analitike njihen pjesët e së tërës (fjala, tingulli, shkronja), ndërsa pastaj, me sintezë, shkohet drejt së tërës. Në këtë mënyrë, njihen njëkohësisht edhe elementet e të folurit. edhe e tëra, por tregohet kujdes edhe për kuptimin e asaj që lexohet. Kjo metodë ka përparësinë se lejon të gërshetohen në mënyrë sistematike gjatë mësimit të leximit dhe shkrimit të tre aspektet themelore të gjuhës, aspekti fonologjik, morfosintaksor dhe semantik.

Në të vërtetë, nuk ka një metodë të përkryer dhe të pazëvendësueshme, e cila do të mund të siguronte një proces të lehtë dhe të shpejtë të mësimit të të lexuarit dhe të të shkruarit. Metodistët dhe mësuesit janë për kombinimin e disa metodave në përputhje me veçoritë e klasës dhe të nxënësve të veçantë. Detyra e mësuesit është, që t'u ofrojë fëmijëve forma pune që tërheqin vëmendjen e tyre dhe që u japin mundësi të shfaqin individualitetin e tyre. Kjo do të thotë që mësuesi duhet të tregojë kujdes për përparimin e çdo fëmije në veçanti. Fëmijët mësojnë më mirë, nëse detyra që u jepet është e rëndësishme për ata personalisht, nëse situata mësimore është tërheqëse dhe nëse është me rëndësi që ata ta zgjidhin problemin që u shtrohet.

LLOJET E TË LEXUARIT NË MËSIMIN FILLESTAR TË SHKRIM-LEXIMIT

Të lexuarit me ngjizje shqiptimore është lloji i të lexuarit, gjatë të cilit mësuesi i orienton fëmijët të dallojnë lidhjen e tingujve a shkronjave në fjalë. Leximi me ngjizje i ndihmon fëmijët që t'i lidhin tingujt brenda fjalës. Ky lloj të lexuari duhet të përdoret sidomos gjatë punës me shkronjat e para.

Të lexuarit fillestar me zë synon përvetësimin e teknikës së të lexuarit. Fëmijët lexojnë një nga një, por nuk duhet shmangur as të lexuarit bashkarisht. Në fillim, mund të lexohen fjalët, kurse më vonë edhe fjalitë duke siguruar edhe të kuptuarit e asaj që lexohet.

Të lexuarit fillestar në heshtje edhe pse nuk është i thjeshtë, realizohet herëpashere duke u dhënë detyrë fëmijëve, që ta lexojnë në heshtje një tekst të shkruar të shkurtër. Mos pritni që të gjithë fëmijët ta plotësojnë me sukses këtë detyrë, por i ndihmoni dhe i nxitni ato, që të përpiqen. Ky lloj të lexuari i ndihmon fëmijët në zbulimin e kuptimit të tekstit të shkruar, kurse për të njohur shkallën e të kuptuarit të tekstit prej tyre, do të duhet të bëhen pyetje për brendinë e tij.

Pas leximit në heshtje, mund t'u jepni rast fëmijëve që, po atë tekst të shkruar, ta lexojnë me zë.

Të lexuarit me seleksionim mund të jetë të lexuar në heshtje ose me zë. Fëmijës i themi që, në tekstin e shkruar, të gjejë fjalët dhe fjalitë që mundet dhe dëshiron t'i lexojë. Një lexim i tillë i motivon nxënësit dhe mundëson edhe individualizimin e mësimit të të lexuarit dhe të të shkruarit fillestar.

PËRMBAJTJA E TEKSTIT MËSIMOR DHE E FLETORES SË PUNËS

Teksti mësimor dhe Fletorja e punës e librit *Valle shkronjash dhe tingujsh 2* kanë lidhje me librin *Valle shkronjash dhe tingujsh 1* dhe janë vazhdim i tyre.

Në tekstin e klasës së parë të shkollës fillore nëntëvjeçare *Valle shkronjash dhe tingujsh 1* kemi synuar të zhvillojmë aftësitë për të dëgjuar dhe dalluar tingujt, për të kuptuar të folurit e të tjerëve, si edhe për të kuptuar rëndësinë e gjuhës së shkruar për komunikimin, për njohjen e të rejave dhe për t'u zbavitur. Për këtë arsye, kanë qenë parashikuar ushtrime për dallimin e tingujve në fillim, në mes dhe në fund të fjalës, ushtrime me tinguj që rimojnë, si edhe dëgjime tekstesh joartistike të lexuara nga mësues-i/ja.

Për të zhvilluar të folurit, në librin *Valle shkronjash dhe tingujsh 1*, kemi ofruar tregime me figura, mbishkrime nga mjedisi përreth dhe lojëra të ndryshme. Për lidhjen e tingujve me shkronjat, kemi përdorur shkronjat lëvizore gjatë veprimtarive të ndryshme, kemi organizuar lojëra që e nxitin këtë shkathtësi, lënie porosish (me shkrim ose me figura) etj. Pra, përmes zhvillimit të të folurit (duke i aftësuar të shprehin atë që mendojnë, të emërtojnë sendet dhe qeniet përreth etj.), duke i mësuar si mbahet libri dhe si kthehen faqet, drejtimin e të shkruarit nga lart-poshtë dhe nga e majta në të djathtë, parimin alfabetik dhe rëndësinë e gjuhës së shkruar për komunikim

etj., i kemi parapërgatitur fëmijët për përvetësimin më me lehtësi të shprehive e shkathtësive për të lexuar e shkruar.

Fëmijët, pra, kur hyjnë në klasën e dytë të shkollës fillore nëntëvjeçare, janë të parapërgatitur për një nga detyrat më të rëndësishme të mësimin të gjuhës amtare në këtë moshë, leximin dhe shkrimin.

Teksti mësimor dhe Fletorja e punës e librit *Valle shkronjash dhe tingujsh 2* siguron realizimin e qëllimeve të Programit mësimor të gjuhës shqipe e të letërsisë, që kanë të bëjnë me mësimin e leximit dhe shkrimin të gjuhës shqipe.

Në përcaktimin e përmbajtjes së tekstit kemi pasur parasysh këto: të pasurojmë fjalorin e nxënësve; t'i aftësojmë ata për t'u shprehur me gojë dhe me shkrim; të ketë shumëllojshmëri tematike të teksteve dhe përputhje me interesat e nxënësve të kësaj moshe. Tematika e teksteve lidhet me jetën e tyre, shkollën, lojën, bimët, kafshët etj.

Problemet gjuhësore të trajtuara janë, para së gjithash, në përputhje me mësimin e të lexuarit dhe të të shkruarit fillestar: tingulli, shkronja, fjala, fjalia dhe teksti i shkruar i lidhur.

Trajtimi i shkronjave shoqërohet sipas rastit me tekste të shkruara ose tregime me figura.

Në tekstet e shkruara ka fjali dëftore, pyetëse dhe nxitëse, kështu që fëmija dallon spontanisht intonacionin e fjalisë dhe shenjën karakteristike të pikësimit në fund të saj. Rregullat drejtshkrimore dhe sqarimet gramatikore që jepen në Tekstin mësimor, janë vetëm konkluzion i asaj që fëmijët e kanë vënë re tashmë dhe nuk duhet të mësohen përmendsh. Mendojmë se informacionet e tilla në Tekstin mësimor, nuk janë të tepërta.

Duke patur parasysh faktin, se fëmijët i përdorin të gjitha këto forma në jetën e përditshme dhe përmes komunikimit në shkollë e në shtëpi, ata, edhe gjatë mësimin të të lexuarit dhe të të shkruarit fillestar, do ta përjetojnë gjuhën si një realitet dinamik, i ndryshueshëm dhe tërheqës.

Përmbajtjet e ofruara mundësojnë përvetësimin, analizën tingëllore dhe shkronjore të fjalëve, leximin e fjalëve dhe të fjalive të shkurtra e të gjata, si edhe, gradualisht, të teksteve të shkurtra e të gjata, pra, përvetësimin e teknikës së të lexuarit dhe të të shkruarit.

Duke pasur në dispozicion të dhëna të tilla, mësuesi/-ja ka mundësi t'i realizojë orët e mësimin në përputhje me kushtet konkrete dhe me veçoritë individuale të çdo nxënësi.

STRUKTURA E TEKSTIT MËSIMOR DHE E FLETORES SË PUNËS

Kapitulli i parë: *Shohim dhe tregojmë*

Kapitulli i parë i *Tekstit mësimor* mban titullin *Shohim dhe tregojmë*. Në këtë kapitull të parë të *Tekstit mësimor*, jepen figura ose grupe figurash, mbi bazën e të cilave fëmijët do të tregojnë. Qëllimi i këtij kapitulli është të zhvillojë të folurit mbi bazën e figurave dhe t'i përgatitë fëmijët për të kaluar gradualisht nga teksti me figura në tekstin e shkruar. Tekstet e krijuara në këtë mënyrë mund të shkruhen në një fletë kartoni dhe, me to, të krijohen libra të përbashkët ose individual, autorë të të cilëve janë nxënësit. Tekstet në faqet e këtyre librave i shkruan mësues-

i/ja me dorë ose në kompjuter, por, po për këtë gjë, mund të angazhohen edhe prindërit. Librat e tillë ruhen në bibliotekën e klasës dhe fëmijët mund t'i shohin ose t'i lexojnë, kur të duan ose kur kanë kohë për një veprimtari të tillë.

Tematika e paraqitur në këto figura është zgjedhur në përshtatje me interesat e fëmijëve dhe është në përshtatje me mjedisin shoqëror dhe natyror që i rrethon ato. Për këtë arsye, figurat paraqesin aspekte nga jeta e tyre në shtëpi, në shkollë, në rrugë, në parkun e lodrave etj.

Kapitulli i parë i *Fletores së punës* mban titullin *Vështrojmë, krahasojmë, vizatojmë*. Në këtë kapitull (të parë) u kërkohet fëmijëve që të ushtrojnë lëvizjet e dorës. U kërkohet të shkruajnë elemente të shkronjave. Duke shkruar elementet e shkronjave, ata mësohen me vijat dhe parapërgatiten për të shkruar me saktësi brenda tyre. Ushtrimet marrin parasysh veçoritë e ndërtimit të shkronjave.

Në kuadër të këtyre ushtrimeve, fëmijët do të krahasojnë figura, do të zhvendosen në plan, do të bëjnë rrahë, do të bëjnë vija të lakuara, do të gjejnë rendin e ngjarjeve etj.

Kapitulli i dytë: Lexojmë dhe shkruajmë

Shkronjat e alfabetit, të shtypit e të dorës, do t'i japim të ndara. Meqenëse nuk ka një mendim të pranuar nga të gjithë lidhur me mënyrën e trajtimit të tyre bashkë ose veç, mësues-i/ja është i lirë të përcaktojë trajtimit të tyre veç e veç apo së bashku.

Radha e mësimi të shkronjave merr parasysh ndarjen në zanore dhe bashkëtingëllore si edhe dendurinë e përdorimit të tyre me qëllim që të bëhet sa më parë e mundur t'u ofrojmë fëmijëve për t'u lexuar, fillimisht, fjalë dhe fjali të shkurtra dhe gradualisht tekste të shkruara tërheqëse dhe me brendi të pasur.

Shkronjat e shtypit

Në çdo një faqe të Tekstit mësimor paraqiten në fillim nga dy shkronja dhe pastaj nga një shkronjë. Çdo shkronjë shoqërohet me një figurë që shënon një send ose një qenie, emërtimi i së cilës fillon me këtë tingull ose shkronjë. Për shembull shkronja *a* shoqërohet me figurën e *ariut*. Figura shërben për emërtimin e asaj që tregohet, për përshkrimin e pamjes, për formimin e fjalive në bazë të figurës, ose edhe të një tregimi të shkurtër. Figura nxit komunikimin gojor për emërtimin e objektit, për përshkrimin e tij, për paraqitjen e përshtypjeve të fëmijëve lidhur me të, për krijimin e fjalive të reja dhe, pse jo, edhe për krijimin e tregimeve vetjake në bazë të tyre.

Pranë figurës ndodhet fjala, shkronjat e së cilës janë të vendosura në etiketë, kështu që fëmijët shohin se fjala e shkruar përbëhet prej shkronjave. Fjalët e tjera që ofrohen në po atë faqe, fillojnë, mbarojnë ose kanë në përbërje të tyre tingullin ose shkronjën në fjalë që do të mësohet, kështu që japin mundësi të organizohen ushtrime për të dalluar shkronjën dhe për të përcaktuar përgjegjësen e saj tingullore, për të përcaktuar vendin e saj në fillim, mes ose në fund të fjalës.

Kur numri i shkronjave të mësuara është ende i vogël (kemi parasysh, sidomos, faqet kush-tuar mësimi të zanoreve) dhe për këtë arsye nuk kemi mundësi t'u ofrojmë nxënësve një tekst të

shkruar interesant për një lexim të pavarur, në faqe, brenda një kornize të caktuar, kemi vendosur një tekst ose vjershë a gjëgjëzë, të cilën mësues-i/ja ua lexon nxënësve (*ariu, iriqi, ylli ...*). Nëse në klasë ka ndonjë nxënës që di të lexojë, atëherë ai mund ta lexojë tekstin e shkruar. Më vonë, ofrohen tekste të shkruara të tilla, që fëmijët mund t'i lexojnë, sepse shkronjat e përfshira në to janë mësuar. Këto janë tekste joartistike të shkurtra e tërheqëse për fëmijët.

Duke filluar nga shkronja *s*, krahas fjalëve, jepen për t'u lexuar edhe fjali e tekste të thjeshta. Në fjalitë ose tekstet që shoqërojnë disa shkronja jepen edhe *emra të përveçëm*. Supozohet se fëmijët, qysh në klasën e parë kanë mësuar ta dallojnë (ta lexojnë), ndërsa, shumë prej tyre, edhe ta vizatojnë (ta shkruajnë) emrin e vet. Si shenjë të identitetit personal, fëmijët e dallojnë dhe e shkruajnë atë edhe para se të shkojnë në shkollë. Përdorimi i emrave të përveçëm në procesin e mësimit të të lexuarit dhe të të shkruarit është i motivuar sepse ata janë të afërt për fëmijët, i lexojnë dhe i shkruajnë me lehtësi. Ata u kujtojnë fëmijëve njerëzit e afërt dhe të dashur që i rrethojnë (prindërit, motrat dhe vëllezërit, shokët ...). Në këtë mënyrë, në procesin e mësimit, futim një aspekt nga jeta e fëmijëve.

Emrat e përveçëm mund të shfrytëzohen gjatë njohjes së çdo shkronje, të shtypit ose të dorës. Fëmijët do të përcaktojnë se me ç'tingull, shkronjë, fillon emri i përveçëm, me ç'tingull mbaron dhe ç'tinguj ka ai në mes. Ata do të gjejnë edhe emra të tjerë, që fillojnë me të njëjtin tingull a shkronjë; do t'i sistemojnë ato në shkronjat lëvizore dhe do të formojnë me to fjali.

Pas punimit të grupeve të caktuara të shkronjave, ekzistojnë ushtrimet *Çfarë nuk i përket rreshtit?* dhe *Luajmë me shkronja*.

Ushtrimet *Çfarë nuk i përket rreshtit?* janë të ngjashme me ushtrimet që fëmijët kanë patur rastin t'i njohin në klasën e parë, vetëm se tani, poshtë figurave, ekzistojnë fjalët e shkruara. Nxënësit kanë për detyrë, që të verifikojnë se ç'gjë është e njëjtë, çfarë është e përbashkët për të gjitha figurat dhe cila prej figurave nuk e ka këtë tipar dhe, sipas kësaj, nuk i përket rreshtit (p.sh: tri fjalët e kanë në fillim shkronjën *a*, ndërsa tek njëra ajo gjendet në fund (**a**utobus, **a**vion, **a**ri, **ka**). Në kuadër të këtyre ushtrimeve, mund të jepen edhe detyra shtesë, të cilat i orientojnë fëmijët, të vënë re gjatësinë e fjalës në varësi të numrit të tingujve; shkronjave, t'i dallojnë dhe t'i lidhin fjalët me të njëjtin numër tingujsh; shkronjash dhe t'u shtojnë fjalëve ekzistuese edhe disa tinguj-shkronja të tjerë. Përveç ushtrimeve të dhëna, mësues-i/ja mund të ofrojë edhe vetë ushtrime të ndryshme. Këto ushtrime zhvillojnë ndjeshmërinë për dallimin e tingujve dhe ndihmojnë për përvetësimin e parimit alfabetik.

Ushtrimet *Luajmë me shkronja* jepen pasi të jenë mësuar një numër i caktuar shkronjash zanore e bashkëtingëllore. Ata kërkojnë prej fëmijëve që shkronjat e renditura gabim t'i vendosin në rendin e caktuar dhe të formojnë kështu fjalën e duhur.

Në *Fletoren e punës*, fëmijët kanë rastin që, në mënyra të ndryshme, të zhvillojnë ushtrime për çdo gjë që prezentohet në *Tekstin mësuesor*. Që në fillim u kërkohet të tregojnë figurën, kur dëgjojnë një tingull të caktuar, të plotësojnë etiketat me shkronja, të renditin shkronjat për të formuar fjalë, të lidhin fjalët me figurat përkatëse, të dallojnë fjalët që janë të shkruara ndryshe në një rresht, të përcaktojnë numrin e fjalëve në fjali, t'i renditin fjalët për të formuar fjali, të bashkojnë rrokjet për të formuar fjalë, të plotësojnë fjalitë, të dallojnë fjalën e saktë në fjali, të dallojnë numrin e fjalëve në fjali, të plotësojnë grupet e fjalëve, t'i renditin fjalët si duhet për të formuar fjali, të vendosin pikën, pikëpyetjen, pikëçuditjen, etj.

Në *Fletoren e punës*, fëmijët ushtrohen në shkrimin e shkronjës përkatëse si edhe ta mbajnë mend formën e saj. Mendojmë se një rresht, për çdo shkronjë shtypi, është i mjaftueshëm.

Propozojmë, që gjatë punimit të shkronjave të përdoret CD^{ia} me *Këngët për shkronjat*. Ato do t'i motivojnë nxënësit për t'i mësuar shenjat e reja grafike dhe do të jenë të dobishme edhe në rastin e kontrollit e të ushtrimeve.

Shkronjat e dorës

Në çdo një faqe të Tekstit mësimor, në fillim, trajtohen dy shkronja dore dhe pastaj katër shkronja. Shkronjat e dorës shoqërohen me tekste të cilat shërbejnë, që të ushtrohet të lexuarit.

Tekstet janë kryesisht joartistike. Ato u ofrojnë fëmijëve aspekte interesante të përshtatshme për moshën e tyre. Ato krijojnë mundësinë për organizimin e veprimtarive të ndryshme.

Përmes teksteve dhe figurave të paraqitura në këtë kapitull, është e mundur dhe kërkohet, që të diskutohet me nxënësit për aspekte të ndryshme që lidhen me jetën dhe formimin e tyre.

Po nuk duhet të harrohet, se qëllimi kryesor është, që fëmijët të mësojnë shkronjat e dorës në mënyrë sa më tërheqëse dhe sa më të përshtatshme për ta.

Në *Fletoren e punës*, në çdo faqe trajtohen dy shkronja. Shkrimi i shkronjave të dorës shoqërohet me ushtrime të ndryshme, në të cilët kërkohet nga nxënësit, të shkruajnë shkronjat e dorës dhe të ushtrohen në lidhjen e tyre me njëra-tjetrën. Fëmijët do të ushtrojnë shkrimin e shkronjave të dorës në vijat, ku ekzistojnë hapësirat e gjera dhe të ngushta.

Njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore

Njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore janë dhënë në përputhje me Programin mësimor për klasën e dytë të shkollës fillore nëntëvjeçare. Këtu përfshihen, para së gjithash, të kuptuarit e fjalisë si një tërësi ligjëruese dhe i pjesëve që e përbëjnë atë, fjalëve dhe tingujve; të dalluarit e shkronjave prej të cilave përbëhet fjala.

Formimi i gjuhësor që fitohet në moshën gjashtë dhe shtatë vjeçe, nuk duhet të jetë formim teorik gramatikor, sepse për fëmijët e kësaj moshe kjo nuk është as e mundur, as e nevojshme. Fillimisht në kopsht dhe pastaj në shkollë, fëmijët ushtrohen të komunikojnë me gojë. Komunikimi me gojë që ushtrohet në kopsht ose në shkollë, në një masë të caktuar, dallohet nga të folurit që ai përdor në shtëpi ose që dëgjon përreth.

Mësimi i rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore, në këtë moshë, bëhet në mënyrën intuitive, pra, fëmijët i dallojnë ose i njohin dukuritë gjuhësore përmes shembujsh. Duke u nisur nga të dhëna konkrete, fëmijët bëhen të aftë, të kuptojnë dhe të mbajnë mend edhe "rregulla" të caktuara, çka shënon edhe fillimin e aftësimit të tyre për të bërë përgjithësime.

Njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore nuk është e domosdoshme të trajtohen si objektiva të veçanta mësimore. Fëmijët i ndeshin dhe i përvetësojnë ato thujse përditë si pjesë

me rëndësi e të lexuarit dhe e të shkruarit fillestar (dallimi i tingujve, shkronjave, fjalëve, fjalive, shenjave të pikësimit në fund të fjalisë, të shkronjave të mëdha në tekstin e shkruar).

Detyrat dhe ushtrimet në *Tekstin mësimor* dhe në *Fletoren e punës* ofrojnë mundësi të ndryshme dhe interesante për mësimin dhe ushtrimin e këtyre përmbajtjeve dhe për përdorimin e mënyrave të ndryshme metodike.

Shenjat drejtshkrimore që vihen në fund të fjalisë janë gjithashtu diçka që nxënësit e kanë të njohur dhe të afërt, po të kihet parasysh se gjatë klasës së parë, kanë patur mjaft raste, që të njihen me tekstin e shkruar dhe t'i vënë re këto shenja. Detyra e mësues-it/es është, që t'u tërheqë vëmendjen rreth këtyre dukurive dhe t'u shpjegojë vlerën e përdorimit të drejtë të pikës, të pikëpyetjes dhe të pikëçuditëses.

Shkrimi i shkronjës së madhe në fillim ka të bëjë me fillimin e fjalisë, me emrat e përveçëm të njerëzve, me emërtimet e qyteteve e të fshatrave dhe me shkrimin e emërtimit të shkollës. Fëmijët i përvetësojnë ato spontanisht duke punuar me tekstin e shkruar: kur lexojnë, kur bisedojnë për tekstin që kanë lexuar (bashkë, në grup apo individualisht), kur shkruajnë ata ose kur shkruan mësues-i/ja. Nxënësit kanë patur shumë raste, që t'i vënë re këto rregulla qysh në klasën e parë.

Emrat janë kategoria e parë gjuhësore që njohin nxënësit. Me emërtimin e sendeve, të qenieve e të dukurive ata ndeshen në çdo moment të jetës së tyre.

Në jetën e tyre të përditshme, si rezultat edhe i specifikës së vetë zonës ku ata jetojnë, fëmijët e Malit të Zi kanë rastin të vënë re se njerëzit flasin edhe në gjuhë të huaj. Njihen, pra, shumë shpejt dhe praktikisht edhe me konceptet gjuhë amtare dhe gjuhë e huaj. Nga ana tjetër, kanë rastin të shohin që fëmijët edhe pse flasin gjuhë të ndryshme, mund të kuptohen dhe të shoqërohen. Këto duhen vlerësuar si hapat e parë në zhvillimin e ndjenjës së tolerancës dhe të respektimit të dallimeve që na rrethojnë, si edhe të pranimit të multikulturave.

Kapitulli i tretë: *Flasim bukur*

Ky kapitull ka të bëjë me rregullat e mirësjelljes dhe të komunikimit në dialog në situatat e ndryshme. Duke patur parasysh se fëmijët kanë patur rastin të ushtrohen dhe t'i përdorin këto rregulla në klasën e parë, brenda këtij kapitulli nuk ofrohet material i shumtë. Ndërkohë, mendojmë se ato mjaftojnë për të kuptuar rregullat e dialogut. Mësues-it/et duhet t'i kenë gjithmonë parasysh dhe të ngulin këmbë vazhdimisht në përvetësimin e tyre në procesin e punës së përditshme. Ndërkaq, mendojmë se fëmijët ende nuk e njohin mirë bisedën telefonike, si një nga llojet e komunikimit, edhe pse shumica e tyre ka pasur rastin që ta përdorë telefonin. Për këtë arsye i kemi kushtuar vëmendje rregullave bazë të një bisede telefonike, me qëllim që fëmijët të përdorin këtë lloj komunikimi në mënyrë të drejtë.

Në kuadër të këtij kapitulli, fëmijëve u ofrohen disa tregime me figura, të cilat paraqesin ngjarje të ndryshme, për të cilat do të jepen vlerësime personale, duke dalluar, pra, sjelljet e dëshirueshme nga ata të padëshirueshme të personave të dhënë. Fëmijët, duke u mbështetur tek figurat e dhëna, mund të krijojnë edhe ata tregimet e tyre vetjake. Me shembujt e *Tekstit mësimor*, fëmijëve u jepet mundësia, që të vënë re se i njëjti urdhër, ndalim, mund të shprehet në mënyra të ndryshme. Në këtë rast, me ndihmën e mësues-it/es, ata vlerësojnë se cila mënyrë

e të drejtuarit dikujt është më e njerëzishme. Në bazë të këtyre shembujve, mund të mendohen orët e mësimit, në të cilat fëmijët do të vihen në situatat, që urdhërat, ndalimet e përzgjedhura të shprehura në mënyrën urdhërore, t'i zëvendësojnë me fjalë të ngjashme, po që do ta bëjnë bisedën më të njerëzishme.

Kapitulli i katërt: *Ne dhe bota përreth*

Në librin e mësuesit të tekstit *Valle shkronjash dhe tingujsh 1*, është theksuar se mësimi i gjuhës realizohet kryesisht me tekste joletrare. Studimet kanë provuar se fëmijët i lexojnë shumë më mirë tekstet letrare, sesa ato joletrare dhe se i përvetësojnë përmbajtjet e teksteve letrare më lehtë sesa ato të teksteve të lëndëve të tjera mësimore që janë joletrare. Për këtë arsye kërkohet që fëmijët të mësohen t'i lexojnë edhe këto lloj tekstesh.

Kapitulli *Ne dhe bota përreth* i kushtohet mjedisit natyror dhe shoqëror në të cilin ndodhen fëmijët dhe aspekteve interesante që lidhen me to. Në këtë kapitull jepen tekste të ndryshme shkencoro-popullore, që flasin për këtë mjedis, kështu që nxënësit, duke ushtruar mënyrën e të lexuarit të teksteve joletrare, mësojnë çfarë është toka, çfarë janë retë, çfarë është pema, lopa, trupi i njeriut etj.

Duhet të kemi parasysh, se në përputhje me Programin e ri mësimor për ciklin e parë tre-vjeçar, tekstet joletrare përfshijnë:

1. Ushtrime për njohjen e rregullave kryesore të komunikimit me dialog (të thonë diçka për veten, të dinë kujt t'i drejtohen me *Ju* dhe kujt jo; si duhet të përshëndetin, si të kërkojnë ndjesë; si t'i luten dikujt për diçka (shprehja *të lutem*), si të falënderojnë (shprehja *faleminderit*), si të shprehin mirënjohjen; si të ftojnë dikë (*ftesa*), si të zhvillojnë një bisedë telefonike).
2. Ushtrime për t'u prezentuar; prezentimi në takimin e parë i vetvetës, i dikujt ose diçkaje tjetër (përshkrimi i personit dhe i sendit, përshkrimi i kafshës, i mënyrës së jetesës së saj); njoftimi i të rejave për ngjarjet aktuale; interesante.
3. Tekste shkencoro-popullore lidhur me njohjen e natyrës dhe të mjedisit shoqëror.
4. Mbishkrime publike (shenjat dhe urdhëresat në qarkullimin rrugor, piktogramet e tjera të thjeshta, urdhëresat, ndalimet, paralajmërimet, përshëndetjet, urimet, lavdërimet, ftesat ...).

Tekstet joletrare kanë karakter informativ, përmbajnë të dhëna për veçoritë e natyrës dhe të mjedisit shoqëror. Tekste të tilla janë objektive, reale dhe nuk kanë karakteristikat e gjuhës së letërsisë artistike (fjalë të zgjedhura, kuptime të figurshme, renditje të veçantë të fjalëve etj.).

Puna me tekstet shkencoro-popullore duhet t'i aftësojë fëmijët për të bërë kërkime të pavarura të informacioneve. Fëmijët duhet të ushtrohen në përdorimin e teksteve mësimore dhe të burimeve të tjera (p.sh. enciklopeditë, revistat, fjalorët, internetin, etj.).

Duke u ofruar fëmijëve lexime të teksteve joletrare, i mësojmë ata, se si të mësojnë duke lexuar. Elementi kyç gjatë mësimit të të lexuarit është *të kuptuarit*. Të kuptuarit gjatë leximit është i pranishëm që në fillim të procesit të leximit të teksteve të shkruara dhe shërben si mbështetje për procesin e përgjithshëm të mësimit (mbajtjen mend, përsëritjen, dallimin).

Të kuptuarit e asaj që lexohet, përkufizohet si procesi aktiv, në të cilin lexuesi, në përputhje me njohuritë e veta të mëparshme, përpiket të interpretojë atë që ka lexuar.

Në procesin e të kuptuarit të tekstit të ri të shkruar, rol të veçantë kanë njohuritë e mëparshme të lexuesit dhe fondi i fjalëve që ai zotëron. Prandaj, është e domosdoshme që, në mënyra të ndryshme, t'i aktivizojmë njohuritë e mëparshme të nxënës-ve/eve dhe t'u rikujtojmë atyre koncepte dhe informacione të njohura. Këto koncepte dhe informacione do t'i ndihmojnë ata, që të kuptojnë informacionet e reja në tekstin e shkruar.

Mënyra e leximit të teksteve joletrare është e ndryshme nga mënyra e leximit të teksteve letrare dhe duhet të punohet për përvetësimin dhe zhvillimin e saj.

Në literaturën metodike bashkëkohore, përdoret termi strategjia e leximit, me të cilën kuptohet rruga më e mirë dhe më e arsyeshme që duhet të ndiqet për të kuptuar materialin që lexohet. Gjatë leximit, në një farë mënyre, ne e përpunojmë tekstin e shkruar. Rezultati përfundimtar duhet të jetë të kuptohet dhe të mbahet mend ajo që lexohet.

Veprimtaritë themelore në strategjinë e leximit të një teksti joletrar janë:

1. Aktivizimi para fillimit të leximit të njohurive të nxënës-ve/eve për llojin dhe specifikën e tekstit që do të lexohet; pra të lidhen njohuritë e mëparshme me të dhënat kryesore të tekstit që do të lexohet duke mundësuar kështu të kuptuarit e tij gjatë leximit;
2. Kontrolli i saktësisë së renditjes së informacioneve gjatë leximit, nëse është nevoja krijohet një renditje e re. Gjatë leximit të tekstit mund të rikthehemi disa herë në të dhënat më pak të njohura ose krejtësisht të reja;
3. Organizimi e rindërtimi i informacioneve të fituara dhe vlerësimi i tyre pas leximit;
4. Veprimtaritë e mësipërme sigurojnë mbajtjen mend të informacioneve që sjell teksti.

Këto janë edhe katër etapat kryesore të veprimtarive metodike për leximin e një teksti joletrar.

Leximi i teksteve joletrare në mësimin e gjuhës amtare ka si qëllim t'u japë nxënësve strategjinë ose mënyrën e të lexuarit të këtyre teksteve dhe për pasojë aftësimin e tyre për të mësuar përmes leximit. Dallimi i të dhënave në tekstin që lexohet, lidhja me njohuritë e mëparshme që fëmijët zotërojnë, veçimi i esenciales nga joesencialja dhe i të njohurës nga e panjohura, paraqitja e të dhënave në një mënyrë tjetërsoj (skemë, grafik), si edhe kuptimi i tekstit të lexuar, janë qëllimet parësore të kësaj veprimtarie. Hollësitë nga mjedisi natyror dhe shoqëror, për të cilat flitet në tekstet e shkruara, janë të dorës së dytë. Pra, qëllimi parësor është të aftësohen të fitojnë njohuri përmes leximit, gjë që përbën edhe thelbin e punës së tyre në shkollë për përvetësimin e njohurive përmes leximit të teksteve përkatëse shkollore. Pra, përvetësimi i njohurive në këtë kapitull nuk është parësor dhe qëllim në vete, sepse fëmijët do të vazhdojnë, edhe më tej, të fitojnë njohuri sistematike për natyrën dhe për shoqërinë në mësimin e Lëndës *Natyra dhe shoqëria*.

Kështu, puna me piktogramet në *Valle shkronjash dhe tingujsh 1*, për shembull për shenjat e qarkullimit rrugor, ka si qëllim "leximin" dhe shpjegimin e mesazhit që transmetojnë piktogramet, d.m.th. zbulimin e kuptimit që ato bartin, kurse në mësimet që lidhen me lëndën Natyra dhe shoqëria, në qendër të vëmendjes është respektimi i rregullave të sjelljes në qarkullimin rrugor. Në këtë kuptim, mësues-it/et duhet të bëjnë dallimin midis këtij kapitulli të mësimin në Lëndën e gjuhës amtare dhe të atij në Lëndën e natyrës dhe të shoqërisë.

Ushtrimet në *Fletoren e punës* lidhur me këtë kapitull, sigurojnë dallimin dhe veçimin e të dhënave thelbësore nga teksti i shkruar, si edhe kontrollin e kuptimit të asaj që është lexuar. Në njërin prej këtyre ushtrimeve (dielli), fëmijët kanë si detyrë, për shembull, të provojnë si formohet hija.

Ushtrimet pranë teksteve në *Fletoren e punës* nxitin zhvillimin gradual të shprehive e shkathtësive gjuhësore. Përmes tyre kontrollohet shkalla e kuptimit të tekstit të lexuar dhe informacionet që ai përmban.

Qëllimet e këtyre ushtrimeve, krahas atyre që u përmendën, janë edhe pasurimi i fjalorit të nxënësve, si edhe njohja e proceseve dhe rezultateve të përfutuara. Nxënësit zhvillojnë kështu aftësinë gjuhësore të të treguarit dhe të përdorimit të drejtë të koncepteve të caktuara.

Në këtë rast ndihma e prindërve është normale. Pra, prindërit mund të ndihmojnë në procesin e zhvillimit të shkathtësive gjuhësore të fëmijëve të tyre.

Në këtë Libër do të japim edhe disa udhëzime për mësuesit.

Udhëzimet për mësuesit mund të shërbejnë si parapërgatitje për realizimin e orëve të mësimi. Ato përmbajnë qëllimet, konceptet, materialet e nevojshme, udhëzimet për realizimin e çdo veprimtarie.

Udhëzimet për mësuesit janë vetëm propozime. Në to përcaktohen procedura të cilat mund t'i përshtaten klasës suaj si tërësi. Për fëmijët që janë në një nivel më të ulët, mund të thjeshtësohen strukturat sintaksore dhe të synohet që të ketë më pak fjalë dhe koncepte. Mësuesit duhet të jenë krijuar në realizimin e orëve të mësimi të gjuhës, sa herë që kjo do të jetë e nevojshme.

Gjithsesi fëmijët duhet të jenë të motivuar. Motivimi nxit dëshirën për komunikim, kështu që fëmijët marrin pjesë me gëzim në shkëmbimin e përvojave të veta me shokët e klasës, me mësues-in/en dhe me familjen. Ky është edhe një nga qëllimet kryesore të këtyre ushtrimeve.

Pas përfundimit të veprimtarisë mësimore, fëmijëve u jepen detyra me karakter figurativ.

Duke pasur parasysh, se përmbajtje e tekstit mësimor për klasën e parë kanë qenë kryesisht ilustrimet në Librin e mësuesit, janë propozuar përgatitjet për realizimin e të gjitha orëve të ofruara në Tekstin mësimor dhe të parashikuara me Programin mësimor. Meqënëse Teksti mësimor dhe Fletorja e punës e klasës së dytë përmbajnë materiale të mjaftueshme për realizimin e një procesi sistematik të mësimi të shkrim-leximit dhe për zhvillimin e dialogut si mënyrë komunikimi, e kemi konsideruar të tepërt, të propozojmë përgatitjet për realizimin e këtyre orëve të mësimi. Risi në Programin mësimor janë tekstet joartistike, të cilat në Tekstin mësimor dhe në Fletoren e punës janë dhënë në kapitullin *Ne dhe bota përreth*. Në Tekstin mësimor, përkrah tyre, gjenden pyetjet të cilat do të duhej t'i tërhiqnin dhe t'i motivonin nxënësit për njohjen e të dhënave që ofrojnë. Në Fletoren e punës, krahas kësaj, janë dhënë edhe pyetjet dhe detyrat e sistemuara për kontrollin e kuptimit të teksteve të shkruara dhe në aftësimin për krijimin e teksteve të ngjashme. Për qëllimet e parashikuara, me këtë kapitull ofrojmë disa mundësi realizimi. Natyrisht, sikurse edhe në Manualin për *Valle shkronjash e tingujsh 1*, këto propozime nuk janë të detyrueshme, por vetëm ndihmojnë në zgjedhjen e varianteve për realizimin e qëllimit konkret të punës me tekstet joartistike.

**ECURIA METODIKE PËR
REALIZIMIN E SYNIMEVE.
MODELE MËSIMESH.**

Kur nuk kishte telefon

Qëllimi: Të perceptojnë dhe analizojnë tekste të shkurtra joartistike në përshtatje me moshën e tyre, të aftësohen, që të lexojnë me zë dhe të kuptojnë tekstin; të dallojnë të dhënat kryesore, të shfaqin mendimin e tyre për tekstin e dhënë dhe përvojat e veta për të njëjtën temë, të aftësohen për të krijuar tekste të ngjashme në përputhje me moshën.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- në bazë të figurës në fq. 71 të Tekstit mësimor zhvillon me nxënësit bisedën për mënyrat e ndryshme të komunikimit; pyet, çfarë mjetesh përdorim për të komunikuar në largësi. Nëse kanë përdorur telefonin, nëse kanë shkruar ose marrë kartolina, telegrame, letra etj. I pyet gjithashtu se si komunikonin njerëzit në krahinën e tyre para se të dilte telefoni.
- thotë se do të mësojnë diçka më shumë, sesi komunikonin njerëzit, kur nuk kishte telefon. Paraqet tekstin *kur nuk kishte telefon* në Tekstin mësimor, fq. 71; lexon me zë tekstin;
- i fton nxënësit që ta lexojnë tekstin me zë dhe në heshtje, duke u përpjekur që të mbajnë mend sa më shumë informacione dhe të veçojnë fjalët më pak të njohura;
- bën pyetje për tekstin: a kishin telefon njerëzit e lashtë, si komunikonin ata, kur ishin larg njëri-tjetrit, çfarë ishin tamburet, përse i përdornin, po indianët si komunikonin në largësi, çfarë përdornin, çfarë tregonte tymi në luftëra; kërkon nga nxënësit që të gjejnë në tekst fjalitë në të cilat gjenden këto informacione dhe t'i lexojnë ato; gjatë bisedës shpjegon fjalët që i njohin më pak;
- pyet nxënësit se cilat të dhëna janë të reja për ta dhe cilat u duken më interesante;
- u tregon nxënësve telefonin duke u shpjeguar se kur është shpikur dhe si përdoret; i fton nxënësit që të tregojnë mjete të tjera komunikimi në largësi, që përdoren sot, si kartolina, letra, telegrami, kompjuteri etj.

Vërejtjet e mësues-it/es

Ndalimet, paralajmërimet dhe lajmërimet (1)

Qëllimi: Të zhvillojnë aftësinë për të lexuar me zë urdhra, ndalime, paralajmërimet dhe lajmërimet të thjeshta, të shtypura nga mjedisi ku jetojnë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- zhvillon bisedën për ndalimet, paralajmërimet dhe lajmërimet e shtypura në klasë ose në korridorin e shkollës. I pyet pse janë të rëndësishme, kush i vë ato, si duhet të silleni në përputhje me to etj.;
- u tregon nxënësve porositë e shtypura në fq. 72-73 të Tekstit mësimor; zhvillon me ta bisedën: kërkon t'i lexojnë ato, të thonë se ku i shohin zakonisht, pse i vënë, ku i kanë parë ata; si duhet të sillen në përputhje me to etj.;
- kërkon nga nxënësit që të shpjegojnë ndalesat, paralajmërimet dhe lajmërimet në fq. 72-73; zhvillon me ta bisedën për to;
- i fton nxënësit, që të kujtojnë ndonjë porosi tjetër, të cilën kanë patur rastin ta shohin, të thonë ku e kanë parë dhe pse është vendosur.

Vërejtjet e mësues-it/es

Ndalimet, paralajmërimet dhe lajmërimet (2)

Qëllimi: Të zhvillojnë aftësinë për të lexuar me zë urdhra, ndalime, paralajmërimet dhe lajmërimet të thjeshta, të shtypura, nga mjedisi ku jetojnë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- i ndan nxënësit në grupe;
- çdo grupi i jep për detyrë që të krijojë ndonjë ndalim, paralajmërim dhe lajmërim të shtypur ose me figurë dhe të përgatisë prezentimin e tyre, duke thënë se ku e vënë, kush e vë, pse është i rëndësishëm, si duhet të sillemi në përputhje me të; i kontrollon nxënësit dhe i ndihmon, nëse është e nevojshme;
- i fton përfaqësuesit e grupeve që të paraqesin punimet e veta, ndërsa nxënësit e tjerë të ndjekin me vëmendje dhe të japin vlerësimet e tyre për punën e shokëve;

**Punimet mund të shërbejnë për të bërë Librin e klasës për ndalimet, paralajmërimet dhe lajmërimet e shtypura.*

Vërejtjet e mësues-it/es

Toka është e rrumbullakët

Qëllimi: Të perceptojnë dhe analizojnë tekste të shkurtra joletrare në përshtatje me moshën e tyre, të aftësohen, që të lexojnë me zë dhe të kuptojnë tekstin; të dallojnë të dhënat kryesore, të shfaqin mendimin e tyre për tekstin e dhënë dhe përvojat e veta për të njëjtën temë, të aftësohen për të krijuar tekste të ngjashme në përputhje me moshën.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- i fton fëmijët të dëgjojnë kompozimin *Globi rrotullohet*; fillon bisedën për këngën, pyet se çfarë është globi, ku jetojmë ne, çfarë ka në tokën tonë, etj. Gjatë kësaj bisede u tregon edhe globin;
- u thotë se do të mësojnë diçka më shumë për tokën.
- në Tekstin mësimor, fq.74, lexon me zë tekstin Toka është e rrumbullakët;
- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin me zë dhe pastaj në heshtje, duke u përpjekur që të mbajnë mend sa më shumë informacione dhe të veçojnë fjalët që i kanë pak të njohura;
- u bën pyetje për tekstin: Si është toka? Çfarë ka në tokë? A ndryshon ajo nga Dielli dhe nga Hëna? etj.; kërkon nga nxënësit që të gjejnë në tekst fjalitë në të cilat jepen këto të dhëna dhe t'i lexojnë ato; gjatë bisedës shpjegon fjalët që i kanë pak të njohura;
- i pyet nxënësit se cilat informacione kanë qenë të reja për ta dhe çfarë u është dukur më interesante nga ajo që kanë mësuar;
- organizon veprimtarinë “Si formohet dita dhe nata” sipas udhëzimeve në Tekstin mësimor; kontrollon punën e tyre dhe i ndihmon, nëse është e nevojshme.

Vërejtjet e mësues-it/es

Çfarë janë retë?

Qëllimi: Të perceptojnë dhe analizojnë tekste të shkurtra joartistike në përshtatje me moshën e tyre, të aftësohen, që të lexojnë me zë dhe të kuptojnë tekstin; të dallojnë të dhënat kryesore, të shfaqin mendimin e tyre për tekstin e dhënë dhe përvojat e veta për të njëjtën temë, të aftësohen për të krijuar tekste të ngjashme në përputhje me moshën.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- fillon bisedën me nxënësit për kohën, i pyet si është koha në vjeshtë dhe në dimër, çfarë bie, çfarë janë retë.
- u thotë se do të mësojnë diçka më shumë për retë.
- në Tekstin mësimor, fq.75, lexon me zë tekstin "Çfarë janë retë?";
- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin me zë dhe pastaj në heshtje, duke u përpjekur që të mbajnë mend sa më shumë informacione dhe të veçojnë fjalët që i kanë më pak të njohura;
- fillon bisedën për tekstin, duke pyetur e nxitur që në bazë të tekstit të thonë se çfarë janë retë, shiu, breshëri dhe bora, çfarë janë vetëtimat dhe bubullimat; kërkon nga nxënësit që të gjejnë në tekst fjalitë në të cilat jepen këto të dhëna dhe t'i lexojnë ato; gjatë bisedës shpjegon fjalët që i kanë pak të njohura;
- i pyet nxënësit se cilat informacione kanë qënë të reja për ta dhe çfarë u është dukur më interesante nga ajo që kanë mësuar;
- u kërkon të vizatojnë një ditë me re dhe, pasi nxënësit të kenë mbaruar detyrën, të bëjnë vlerësimin e vizatimeve të tyre.

Vërejtjet e mësues-it/es

Çfarë është lopa?

Qëllimi: Të perceptojnë dhe analizojnë tekste të shkurtra joletrare në përshtatje me moshën e tyre, të aftësohen, që të lexojnë me zë dhe të kuptojnë tekstin; të dallojnë të dhënat kryesore, të shfaqin mendimin e tyre për tekstin e dhënë dhe përvojat e veta për të njëjtën temë, të aftësohen për të krijuar tekste të ngjashme në përputhje me moshën.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- fillon bisedën me nxënësit për kafshët shtëpiake, i pyet a kanë lopë në shtëpi, si është lopa e tyre, me se ushqehet, si quhet i vogli i lopës, çfarë marrin prej lopës etj.
- u thotë se do të mësojnë diçka më shumë për lopën.
- në Tekstin mësimor, fq.76, lexon me zë tekstin “Lopa”;
- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin me zë dhe pastaj në heshtje, duke u përpjekur që të mbajnë mend sa më shumë informacione dhe të veçojnë fjalët që i kanë pak të njohura;
- fillon bisedën për tekstin, duke pyetur e nxitur që në bazë të tekstit të thonë se **çfarë janë lopët**, si e kanë trupin, çfarë kanë në kokë, çfarë marrin prej lopës, çfarë bëjmë me qumështin e lopës etj.; kërkon nga nxënësit që të gjejnë në tekst fjalitë në të cilat jepen këto të dhëna dhe t'i lexojnë ato; gjatë bisedës shpjegon fjalët që i kanë pak të njohura;
- i pyet nxënësit se cilat informacione kanë qënë të reja për ta dhe çfarë u është dukur më interesante nga ajo që kanë mësuar;
- u kërkon të vizatojnë lopën dhe, pasi nxënësit ta kenë mbaruar detyrën, të bëjnë vlerësimin e vizatimeve të tyre.

Vërejtjet e mësues-it/es

Çfarë është Dielli?

Qëllimi: Të perceptojnë dhe analizojnë tekste të shkurtra joletrare në përshtatje me moshën e tyre, të aftësohen, që të lexojnë me zë dhe të kuptojnë tekstin; të dallojnë të dhënat kryesore, të shfaqin mendimin e tyre për tekstin e dhënë dhe përvojat e veta për të njëjtën temë, të aftësohen për të krijuar tekste të ngjashme në përputhje me moshën.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- fillon bisedën me nxënësit për diellin, i pyet çfarë është dielli, a është i madh dielli, a lëviz ai, çfarë ndodh kur në qiell ka re etj.
- u thotë se do të mësojnë diçka më shumë për diellin.
- në Fletoren e punës, fq.81, lexon me zë tekstin “Dielli është një trup i zjarrtë”;
- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin me zë dhe pastaj në heshtje, duke u përpjekur që të mbajnë mend sa më shumë informacione dhe të veçojnë fjalët që i kanë pak të njohura;
- u bën pyetje për tekstin: çfarë është dielli, çfarë bën ai në mëngjes, në darkë, përse duket i vogël, çfarë sjell dielli në tokë, po hëna dhe yjet pse nuk ngrohin; kërkon nga nxënësit që të gjejnë në tekst fjalitë në të cilat jepen këto të dhëna dhe t'i lexojnë ato; gjatë bisedës shpjegon fjalët që i kanë pak të njohura;
- i pyet nxënësit se cilat informacione kanë qënë të reja për ta dhe çfarë u është dukur më interesante nga ajo që kanë mësuar;
- organizon veprimtarinë “Si formohet hija” sipas udhëzimeve në Tekstin mësimor; kontrollon punën e tyre dhe i ndihmon, nëse është e nevojshme.

Vërejtjet e mësues-it/es

Çfarë është deti?

Qëllimi: Të perceptojnë dhe analizojnë tekste të shkurtra joletrare në përshtatje me moshën e tyre, të aftësohen, që të lexojnë me zë dhe të kuptojnë tekstin; të dallojnë të dhënat kryesore, të shfaqin mendimin e tyre për tekstin e dhënë dhe përvojat e veta për të njëjtën temë, të aftësohen për të krijuar tekste të ngjashme në përputhje me moshën.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- fillon bisedën me nxënësit për detin, i pyet a kanë qenë ndonjëherë në det, çfarë dinë ata për detin, për mjetet detare të udhëtimit etj.
- u thotë se do të mësojnë diçka më shumë për detin.
- në Fletoren e punës, fq.82, lexon me zë tekstin “Çfarë është deti?”
- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin me zë dhe pastaj në heshtje, duke u përpjekur që të mbajnë mend sa më shumë informacione dhe të veçojnë fjalët që i kanë pak të njohura;
- u bën pyetje për tekstin: çfarë është deti, si e ka ujin, si e ka ngjyrën, çfarë ka në det, për se shërbejnë varkat dhe anijet në det etj.; kërkon nga nxënësit që të gjejnë në tekst fjalitë në të cilat jepen këto të dhëna dhe t'i lexojnë ato; gjatë bisedës shpjegon fjalët që i kanë pak të njohura;
- i pyet nxënësit se cilat informacione kanë qenë të reja për ta dhe çfarë u është dukur më interesante nga ajo që kanë mësuar;
- organizon veprimtarinë “Si formohen dallgët në det”, sipas udhëzimeve në Tekstin mësimor; kontrollon punën e tyre dhe i ndihmon, nëse është e nevojshme.

Vërejtjet e mësues-it/es

Çfarë janë pemët?

Qëllimi: Të perceptojnë dhe analizojnë tekste të shkurtra joletrare në përshtatje me moshën e tyre, të aftësohen, që të lexojnë me zë dhe të kuptojnë tekstin; të dallojnë të dhënat kryesore, të shfaqin mendimin e tyre për tekstin e dhënë dhe përvojat e veta për të njëjtën temë, të aftësohen për të krijuar tekste të ngjashme në përputhje me moshën.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- bisedën e fillon me pyetjen: A e di, se çfarë do të thotë fjala *pemë*? Rendit kuptimet e mundshme për këto fjalë (*dru frytor* dhe *fryti i drurëve frytorë*), në mënyrë që t'i ndihmojë fëmijët që ta përcaktojnë kuptimin e saj;
- shpjegon kuptimin e fjalës *pemë*; thotë se ky është një dru që ka një trung, degë dhe gjethë.
- pyet, se çfarë pemësh ka në krahinën e tyre, nga dalin frutat e pemëve etj.
- u thotë se do të mësojnë diçka më shumë për pemët.
- në Fletoren e punës, fq.83, lexon me zë tekstin “Çfarë janë pemët?”;
- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin me zë dhe pastaj në heshtje, duke u përpjekur që të mbajnë mend sa më shumë informacione dhe të veçojnë fjalët që i kanë pak të njohura;
- fillon bisedën për tekstin, duke pyetur e nxitur që në bazë të tekstit të thonë çfarë janë pemët, rrënjët, degët, përse shërbejnë ato etj.; kërkon nga nxënësit që të gjejnë në tekst fjalitë në të cilat jepen këto të dhëna dhe t'i lexojnë ato; gjatë bisedës shpjegon fjalët që i kanë pak të njohura;
- i pyet nxënësit se cilat informacione kanë qënë të reja për ta dhe çfarë u është dukur më interesante nga ajo që kanë mësuar;
- u kërkon të vizatojnë një pemë ose një kopsht me pemë dhe, pasi nxënësit ta kenë mbaruar detyrën, të bëjnë vlerësimin e vizatimeve të tyre.

Vërejtjet e mësues-it/es

Njerëzit, kafshët dhe bimët ushqehen.

Qëllimi: Të perceptojnë dhe analizojnë tekste të shkurtra joletrare në përshtatje me moshën e tyre, të aftësohen të lexojnë me zë dhe të kuptojnë tekstin; të dallojnë të dhënat kryesore, të shfaqin mendimin e tyre për tekstin e dhënë dhe përvojat e veta për të njëjtën temë, të aftësohen për të krijuar tekste të ngjashme në përputhje me moshën.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- fillon bisedën me nxënësit për ushqimin e kafshëve, i pyet se me se ushqehen macet, pulat, lopët, delet, luanët, shqiponjat etj.
- u thotë se do të mësojnë diçka më shumë për ushqimin e kafshëve, të bimëve e të njerëzve.
- në Fletoren e punës, fq.84, lexon me zë tekstin “Kafshët ushqehen”;
- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin me zë dhe pastaj në heshtje, duke u përpjekur që të mbajnë mend sa më shumë informacione dhe të veçojnë fjalët që i kanë pak të njohura;
- u bën pyetje: Me se ushqehen kafshët? A ushqehen bimët? Si ushqehen bimët? Me se ushqehet njeriu, kur është i vogël dhe me se, kur rritet? etj. Kërkon nga nxënësit që të gjejnë në tekst fjalitë, në të cilat jepen këto të dhëna dhe t'i lexojnë ato; gjatë bisedës shpjegon fjalët që i kanë pak të njohura;
- i pyet nxënësit se cilat informacione kanë qënë të reja për ta dhe çfarë u është dukur më interesante nga ajo që kanë mësuar;

Vërejtjet e mësues-it/es

Trupi ynë

Qëllimi: Të perceptojnë dhe analizojnë tekste të shkurtra joletrare në përshtatje me moshën e tyre, të aftësohen të lexojnë me zë dhe të kuptojnë tekstin; të dallojnë të dhënat kryesore, të shfaqin mendimin e tyre për tekstin e dhënë dhe përvojat e veta për të njëjtën temë, të aftësohen për të krijuar tekste të ngjashme në përputhje me moshën.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- në bazë të figurës në fq.85 të Fletores së punës, zhvillon me nxënësit bisedën për trupin e tyre; pyet për pjesët përbërëse të trupit të tyre, përse u shërbejnë sytë, hunda, goja veshët, si e ruajnë ata trupin e tyre.
- u thotë se do të mësojnë diçka më shumë për trupin e njeriut.
- në Fletoren e punës, fq. 85 lexon me zë tekstin "Trupi ynë";
- i fton nxënësit, që të lexojnë tekstin me zë dhe pastaj në heshtje, duke u përpjekur që të mbajnë mend sa më shumë informacione dhe të veçojnë fjalët që i kanë pak të njohura;
- fillon bisedën për tekstin, duke pyetur e nxitur që në bazë të tekstit të thonë si dhe prej se është i përbërë trupi i njeriut, çfarë ka në kokën e njeriut, si e kuptojnë që në trupin e njeriut ka gjak, për se shërbejnë sytë, hunda, goja, me se mendojnë ose shohin ëndrra, ku është zemra e njeriut dhe çfarë bëjnë njerëzit për ta mbajtur të pastër trupin dhe gojën e tyre etj.;
- kërkon nga nxënësit që të gjejnë në tekst fjalitë, në të cilat jepen këto të dhëna dhe t'i lexojnë ato; gjatë bisedës shpjegon fjalët që i kanë pak të njohura;
- i pyet nxënësit se cilat informacione kanë qënë të reja për ta dhe çfarë u është dukur më interesante nga ajo që kanë mësuar.

Vërejtjet e mësues-it/es